

Sot në orët e para të mëngjesit nga Aeroporti Ndërkombëtar "Ademi Jashari", ka udhëtuar për në Mekë të Arabisë Saudite grupi i besimtarët të parë kosovarë, të cilët gjatë ditëve në vijim do e kryejnë Haxhin. Bashkë me besimtarët tanë ka udhëtuar edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë.

Për t'i përcjellë besimtarët tanë, në Aeroport kishin dalë familjarë, miq, përfaqësues të Këshillave të BI Islame dhe përfaqësues të Kryesisë së BIK.

Besimtarët tanë tashmë veç kanë arritur dhe janë akomoduar në Mekë.

Sivjet Haxhin pritët ta kryejnë 865 besimtarë kosovarë. Kryesia e BIK si çdo herë ka bërë përgatitjet e duhura. Me haxhinjtë tanë në vendet e shenjta do të jenë edhe 37 udhëheqës, si dhe ekipi mjekësorë që do të kujdeset për gjendjen shëndetësore të haxhilerëve.

Shkuarja e besimtarëve tanë për në Mekë do të vazhdoj edhe nesër e pasnesër kur pritët të udhëtoj edhe grupi i fundit mi besimtarëve nga Kosova./bislame/